

Informatë për media

Çështjet politike aktuale në Kosovë

25 korrik 2008

Index Kosova, partner me BBSS
Gallup International është kompani
private për hulumtim të opinionit
publik, mediave dhe tregut, e
vendosur në Prishtinë, Kosovë.

Bajram Kelmendi 38, 10000
Prishtinë, Kosovë

Tel/fax: +381 38 247 977

E-mail: office@indexkosova.com


URL: <http://www.indexkosova.com>

Informatat mbi hulumtimin

- ◆ Terreni u krye prej 21-27 qershor 2008
- ◆ Mostra: 998 respondentë shqiptarë dhe minoritete (pa serbë)
- ◆ Mostra reprezentative për popullatën e Kosovës 18+ vjeçare
- ◆ Intervistë 25 minutëshe ballë-për-ballë, në shtëpi të respondentit
- ◆ Çdo e gjashta intervistë e kontrolluar në terren
- ◆ Margjina e gabimit = $\pm 3.1\%$


Problemi më i rëndësishëm në Kosovë

- ◆ Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, tani problem mbizotërues në Kosovë mbetet papunësia. Papunësia edhe më parë ka qenë e theksuar, por pas lënies mënjanë të problemit të statusit, ky problem merr dimension të ri. Problemet tjera, por që bien dukshëm nën hijen e problemit të papunësisë, janë: rryma/KEK-u, rindërtimi i ekonomisë/infrastrukturës, varfëria dhe Mitrovica.




Prioritetet më të rëndësishme për Qeverinë e Kosovës

- ◆ Sipas qytetarëve të Kosovës, tri prioritetet më të rëndësishme me të cilat do të duhej të merrej Qeveria e Kosovës janë: sektori i energjisë, sundimi i ligjit dhe sistemi shëndetësor. Në mesin e prioriteteve të tjera, përmenden edhe sistemi arsimor, shëndeti publik, si dhe programet e ndihmave sociale.




Besimi në institucione

- TMK-ja dhe SHPK-ja mbeten edhe më tutje institucionet më të besuara në Kosovë. Institucionet që kanë shënuar ngritje në besueshmëri janë kryetarët e komunave, Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës. Në anën tjetër, besimi në Policinë e UNMIK-ut ka shënuar rënie të madhe nga 68% në 53%; rënie në besim kanë pësuar edhe gjykatat dhe Lëvizja Vetëvendosje.**



Përkrahja e liderëve

- ◆ **Presidenti Sejdiu bashkë me ish-kryeministrin Agim Çeku, vazhdojnë të mbesin liderët më të përkrahur nga ana e qytetarëve të Kosovës, përderisa menjëherë pas tyre radhiten Kryeministri Thaçi dhe kryetari i AAK-së - Ramush Haradinaj. Përderisa përkrahja ndaj Kryeministrit Thaçi ka shënuar ngritje, përkrahja ndaj liderëve dhe personaliteteve të tjerë është relativisht stabile. Rënie të konsiderueshme në përkrahje kanë shënuar Behgjet Pacolli dhe Veton Surroi.**




Gatishmëria për protesta

- ◆ Shpesh është thënë se zgjidhja e statusit politik nuk do t'i rregullojë përnjëherë të gjitha problemet me të cilat ballafaqohet Kosova. Duke e kuptuar këtë, qytetarët e Kosovës çdo ditë e më shumë, tregojnë gatishmëri për protesta në lidhje me çështje të ndryshme të jetës së përditshme.
- ◆ Ata besojnë se mund të ketë protesta kryesisht për shkak të papunësisë dhe për shkak të gjendjes aktuale të furnizimit me rrymë. Por, gatishmëria për protesta është rritur edhe në lidhje me gjendjen aktuale të furnizimit me ujë, gjendjen aktuale në arsim, si dhe në lidhje me rrogat e vogla.

A është e mundshme që të bëhen protesta për shkak të...	Gusht 2006	Nëntor 2006	Mars 2007	Qershor 2008
	%	%	%	%
rrogave të vogla?	44	44	39	49
papunësisë?	64	64	58	67
gjendjes aktuale në arsim?	45	39	36	48
gjendjes aktuale të furnizimit me ujë?	38	34	29	43
gjendjes aktuale të furnizimit me rrymë?	57	60	45	66
politikave të institucioneve politike në Kosovë?	32	34	30	31

Preferencat votuese

- ◆ **Preferencat aktuale votuese të qytetarëve të Kosovës tregojnë se është rritur numri i atyre që nuk do të votonin për asnjë parti, përderisa ka rënë numri i atyre që janë të përcaktuar. Aktualisht, rreth 71% e qytetarëve janë të përcaktuar se për cilën parti do të votonin.**



Preferencat votuese për Kuvend të Kosovës

- ◆ Koalicioni qeveritar PDK-LDK duket se i ka përforcuar pozicionet e këtyre dy partive në sytë e elektoratit kosovar. Aktualisht për PDK-në do të votonin 42% ndërsa për LDK-në 29% e votuesve.
- ◆ Në anën tjetër, lëvizjet në mesin e opozitës janë po ashtu të konsiderueshme: AAK ka shënuar ngritje në 16%, përderisa AKR ka rënë në 5% dhe LDD në 4%. Gjithashtu, edhe ORA ka shënuar rënie të madhe në 1%, përderisa PSD është ngritur në 1%.

